



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

Procesverbal nga Debatë Publik- Puna e Kryetarit Ilazi të arriturat dhe sfidat për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023

Tema: Puna e Kryetarit Ilazi të arriturat dhe sfidat për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, në objektin e administratës

Data dhe koha: 23 qershor 2023 (e Premte) ; Ora: 14:00

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, nen 68 pika 68.1, Statutit të Komunës, nenit 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun organizoi debat publik me temë: Puna e Kryetarit Ilazi dhe Komunës së Kaçanikut për gjashtë mujorin e parë për vitin 2023. Takimin e hapi Kryetari i Komunës së Kaçanikut Besim Ilazi, i cili falenderoi qytetarët për bashkëpunim dhe pjesëmarrje në debate publike, ku edhe vendimmarrja është më transparente dhe më e kompletuar. Ndërsa në lidhje me realizimin e projekteve foli Nënkyryetari Sabedin Vishi, i cili njoftoi se tashmë kanë filluar shumë projekte kapitale dhe shumë të tjera pritet të fillojnë së shpejti. Nënkyryetari tha se edhe këtë vit do të realizohen projekte të ndryshme kapitale ku disa nga ta tashmë kanë nisur. Nënkyryetari përmendi investimet në projektin e ndërtimit të sheshit të qytetit, në rregullimin e nënkalimit për këmbësor, rregullimin e projektit turistik te Guri i Shpum, investime në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit e ndriçimit publik , në rrugë e trotuare, bujqësi, shëndetësi, investime në arsim, kulturë, rini e sport, investime në bujqësi, në zhvillim ekonomik e turizëm etj.

Selim Reka- U.D. Gjimnazi “ Skenderbeu” Kaçanik

Dëshiroj të kem disa informata rrreth projektit të rrugës Kaçanik- Viti- Kërbliq, ku janë procedurat?

Kërkoj që punimet në Gjimnazin “ Skenderbeu” të kryhen gjatë kohës së pushimeve si dhe kërkoj që të vendoset një pasqyre (shenjë e komunikacionit) tek hyrja e gjimnazit(mbrapa objektit).

Poashtu kërkoj shtrirje të ujësjellësit edhe në lagjen 2 Korriku në rrugën “ Kjani Bela” si dhe kërkoj rregullimin e pjesës ku është vendosur tabela digjitale tek kalaja, sepse ka penguar trotuarin.

Shpat Bulica- kryetar i KVRL-së

A ka investime në fushën e rinisë si dhe më konkretisht në Shtëpinë e Kulturës?

Qëndrim Vogliqi-

Ju përgëzoj për punën, kërkoj që raportin herave tjera ta kemi më herët në mënyrë që të kemi materialin paraprakisht që do ta diskutojmë. Kam ankesë sepse nuk kam marrë asnjë përgjigje në kërkesat e mia që i kam percjellur në komunë. Kërkesat i kam vazhduar edhe këtë vit por që për të njëjtat nuk kam marrë përgjigje. Kërkoj të bëhet publikimi i projektit të parkingut nëntokësor para se të bëhet nënshkrimi i kontratës.

Kur pritet të filloj realizimi i projektit të ndriçimit publik?

Ibrahim Dalloshi-

Kur do të bëhet hapja e ambulantës në Doganaj?

Abedin Vishi- Arsimtar nga Shkolla Fillore “ Qamil Ilazi”

Ju përgëzoj për punën dhe aktivitetet e juaja, ndërsa mund të them se asnjëherë si tani nuk ka pasur një shkëputje aq të madhe nga niveli qendror me atë komunal. Kërkoj që investimet në shkollën tonë të realizohen gjatë kohës së pushimeve. Kërkoj që të rregullohet rruga nga varrezat e dëshmorëve së bashku me trotuarin.

Kadri Dardhishta-

Deri më tani janë realizuar shumë projekte, ndërsa kërkoj që të realizohet rruga “ Kjani Bela”, te lagjja Fera është bërë muri mbrojtës, mungon asfaltimi i rrugës.

Azem Koraqi-

Kanali i ujites në Kovaqec, po i bën dëm një prone private, kërkoj që ky problem të rregullohet.

Hasip Saliu

Ju përgëzoj për punët e deritashme, por njëkohësisht e rrugët lokale nuk janë rregulluar, kemi shumë familje pa asfalt, ndërsa kërkoj që kompensimi i pronave të bëhet më me kujdes.

Procesmbajtëse

Fatlume Guri Selimi

Zyrtare për Informim

